



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/294

14.08.2026

Podujevë

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaze dhe institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), për vitin shkollor 2026-2027 (MASH), referencë 3/2838, dt. 29/06/2026, Drejtoria Komunale e Arsimit në Podujevë shpall:

KONKURS PLOTËSUES

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË INSTITUCIONET E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL PËR VITIN SHKOLLOR 2026/2027

I. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional IAAP “Isa Boletini” Podujevë

Nr.	Fusha	Nr. i nxënësve
1.	Drejtimi: Ekonomi, administrim dhe juridik Profilet:	
a.	Kontabilist	30
b.	Banka dhe sigurime	43
c.	Asistent juridik	44
d.	Administrim i zyrës	22
e.	Asistent i mikpritjes dhe hoteliere - DUAL	11
f.	Kuzhinier – DUAL	9

2.	Drejtimi: Shëndeti dhe mirëqenia Profilet:	
a.	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	19
Gjithsej 178 nxënës		

II. Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional IAAP “Fan S. Noli” Podujevë

Nr.	Fusha	Nr. i nxënësve
1.	Drejtimi: Teknologji e informacionit dhe komunikimit – Profilet:	
a.	Informatikë	6
b.	Teknik i informatikës së biznesit	2
c.	Energjetikë	9
2.	Drejtimi: Makineri, prodhim dhe ndërtimtari – Profilet:	
a.	Instalues elektrik	7
b.	Instalimi ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	2
c.	Trafik rrugor	3
Gjithsej 29 nxënës		

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10), në gjimnaze dhe në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), për vitin shkollor 2026/2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e IX- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e dhjetë (10) institucione të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP), duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- ❖ **Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- ❖ **Dëftesën origjinale** për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- ❖ **Certifikatën e lindjes.**

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve në institucione të arsimit dhe aftësimit profesional (IAAP) për vitin shkollor 2025/2026, bëhet më datë **17, 18 dhe 19 gusht 2026** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8:00-16:00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse më datë **20.08.2026**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës **21 gusht 2026**.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesa në shkallën e dytë bëhet në Drejtorinë Komunale të Arsimit, brenda dy (2) ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e dhjetë (10) duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | | |
|---|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi mund t'i fitojë maksimalisht (100%) 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksemi për shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat 6-9, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksemi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6, 7, 8, 9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksemi (kl. 6+ kl. 7+ kl. 8+kl. 9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max.}$$

Nxënësi nga suksemi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

$$\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max.}$$

❖ **Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP:**

a. Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:
Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi

b. Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi – Teknologji, PTT:
Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi

c. Ekonomi, administratë:

Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

d. Juridik dhe administratë:

Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi

e. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:

Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi

4. Kriteri i suksesit (notat) në lëndët prioritare për drejtimit përkatëse:

- **Shkolla e shëndetësisë** - Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes(Biologji)} + \text{mes(Fizikë)} + \text{mes(Gjuhë shqipe)}}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë

- | | |
|------------------|---------|
| 1. Gjuhë shqipe | 20 pikë |
| 2. Gjuhë angleze | 5 pikë |
- (Gjithsej 25 pikë)**

II. Shkencat shoqërore:

- | | |
|--------------|---------|
| 1. Gjeografi | 12 pikë |
| 2. Histori | 13 pikë |
- (Gjithsej 25 pikë)**

III. Matematikë

- | | |
|----------------|---------|
| 1. Matematikë | 20 pikë |
| 2. Informatikë | 5 pikë |
- (Gjithsej 25 pikë)**

IV. Shkencat natyrore:

- | | |
|-------------|--------|
| 1. Fizikë | 8 pikë |
| 2. Kimi | 8 pikë |
| 3. Biologji | 9 pikë |
- (Gjithsej 25 pikë)**

5. Renditja e lëndëve me përparësi sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | | |
|-----------------------------------|----|----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

- | | | |
|-----------------------------------|----|----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkencat e natyrës | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

III. Ekonomi

- | | | |
|-----------------------------------|----|----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkencat shoqërore | 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat e natyrës | 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | | Totali = 40 pikë |

IV. Juridik

1. Shkencat shoqërore	25	$25 \times 0.8 = 20$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
4. Shkencat e natyrës	25	$25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
		Totali = 40 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze	25	$25 \times 0.8 = 20$ pikë
2. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
4. Shkencat e natyrës	25	$25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
		Totali = 40 pikë

Drejtori
Avni Fetahu

